



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:002714
Datë: 09.08.2024
Numri i dokumentit: 06037380

C.nr.2021:002714

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Burhan Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditëseit R. L. nga fshati ... Kaçanik, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokta N. R. nga Kaçaniku, ndaj të paditurëve G. L. , Z. N. , Sh. L. dhe Sh. L. 1që të gjithë nga Tetova rruga “...” pn., për çështjen kontestuese vërtetimin e të drejtës së pronësisë, jasht seancës, me dt. 09.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e TËRHEQUR padia e paditësit R. L. nga fshati ... Kaçanik, kundër të paditurëve G. L. , Z. N. , Sh. L. dhe Sh. L. 1që të gjithë nga Tetova rruga “...” pn, lidhur me çështjen kontestuese kompenzim dëmi.

II.OBLIGOHET paditësi që të paguaj shumën prej 20€, në emër të taksës për padi.

A r s y e t i m

Paditësi R. L. nga fshati ... Kaçanik ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt. 08.01.2021, lidhur me çështjen kontestuese vërtetimin e të drejtës së pronësisë ndaj të paditurëve G. L. , Z. N. , Sh. L. dhe Sh. L. 1që të gjithë nga Tetova rruga “...” pn.

I autorizuari i paditësve përmes parashtresës së dt. 02.05.2024 e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese paditësi me të paditurit qështjen kontestuese e kanë zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore me marrëveshje.

Gjykata vendosi që të pranoj të tërhequr padinë e paditësve në kuptim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës kontestimore, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e morri konform nenit 12.1 të UA, të KGJK-së nr. 01/2017 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe e detyroi palën paditëse që të paguaj shumën prej 20€ në emër të taksës për padit të pa paguar me rastin e dorëzimit të padisë.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.01/2021, dt. 09.08.2024

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi

nuk është e lejuar ankesa